



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
MINISTRI

Nr. 18743/prot.

112/9  
19/11 4  
Data: 13.11.2024

VENDIM

Nr. 79, Datë 13.11.2024.

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", dhe urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e ofruesit të AFP-së, me të dhëna si më poshtë:

1. Emri i ofruesit të AFP-së: Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli", Berat.
2. Akti zyrtar i themelimit/licencimit: K51703523G.
3. Organizimi i institucionit: Shkollë mesme profesionale publike.
4. Lloji i ofruesit të AFP-së: Shkollë mesme profesionale.
5. Nipti: K51703523G.

Pasi mora në shqyrtim dokumentacionin e vetëvlerësimit, raportin e vetëvlerësimit, dokumentacionin e vlerësimit të jashtëm, raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditim, si dhe të gjithë procedurën e akreditimit të zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK),

**konstatoj se:**

- a. procedura dhe procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditim janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara nga AKAFPK-ja për këtë proces;
- b. vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në dokumentacionin e vetëvlerësimit, vlerësimin e jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në terren;
- c. raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues.

*Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm,*

## VENDOS:

1. Akreditimin me kusht për kualifikimet profesionale:
  - a) "Shërbime mjetesh transporti" Niveli II i KSHK-së, M-II-21
  - b) "Shërbime elektro-auto" Niveli III i KSHK-së, M3-III-22
  - c) "Shërbime mjetesh transporti" Niveli IV i KSHK-së, M-IV-23
  - d) "Diagnostikim dhe menaxhim në autoservis" Niveli V i KSHK-së, M1-V-23
  - e) "Elektroteknikë" Niveli II i KSHK-së, E-II-21
  - f) "Instalime elektrike civile dhe industriale" Niveli III i KSHK-së, E1-III-21
  - g) "Elektroteknikë" Niveli IV i KSHK-së, E-IV-21
  - h) "Mekanikë" Niveli II i KSHK-së, F-II-22
  - i) "Mirëmbajtje dhe riparime mekanike" Niveli III i KSHK-së, F3-III-18
  - j) "Mekanikë" Niveli IV i KSHK-së, F-IV-19
  - k) "Teknologji informacioni dhe komunikimi" Niveli II i KSHK-së, T-II-19
  - l) "Mbështetje e përdoruesve të TIK-ut" Niveli IV i KSHK-së, T2-IV-21
  - m) "Termohidraulikë" Niveli II i KSHK-së, V-II-20
  - n) "Instalime të sistemeve ngrohëse – ftohëse" Niveli III i KSHK-së, V2-III-22
  - o) "Termohidraulikë" Niveli IV i KSHK-së, V-IV-23
1. Afati përfundimtar i akreditimit me kusht është 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Në përputhje me propozimin përkatës nr.112/8 datë 15.10.2024, dërguar nga AKAFPK-ja (bashkëlidhur këtij urdhri):

Ofruesi i AFP-së të plotësojë rekomandimet e paraqitura në propozimin përkatës nr.112/8 datë 15.10.2024, ardhur nga AKAFPK-ja, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
2. Ofruesi i AFP-së t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional sipas kësaj rregulloreje, çdo 4 vjet.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendim, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

